



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 451/1 prot.

Tiranë, më 24 . 04. 2023

### V E N D I M

**Nr. 60, datë 24. 04. 2023**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup> është paraqitur ankesa nr. 52, datë 29.03.2023, e L. K. kundër Agjencisë Shtetërore të Kadastrës<sup>3</sup> dhe Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Fier<sup>4</sup>, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes shoqërore<sup>5</sup>” dhe “çdo shkak tjetër<sup>6</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### K O N S T A T O I :

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna, ankuesi në mes të tjerash informon se: “Me vendimin nr.132, datë 14.02.1996, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish pronarëve ka vendosur të njohë dhe të kompensojë trashëgimtarët ligjorë të J. K. Midis të tjerëve dhe gjyshin tim Ll. K. Vendimi i regjistruar sipas ligjit dhe për këtë arsye u lëshua Nota e transkriptimit nr.1143, datë 06.07.1996. Në cilësinë e trashëgimtarit të të ndjerit Ll. K. kam aplikuar për riregjistrimin e pronës duke bërë dhe pagesat përkatëse, pasi sipas Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, regjistrimet para vitit 1997 janë djegur. Në zbatim të Urdhrit nr. 664, datë 1.12.2015 të kryeregjistruesit është disponuar refuzimi i kërkesës time për regjistrimin e vendimit pasi krijon mbivendosje me pasurinë e regjistruar sipas VKM nr. 509, datë 6.7.2011 në emër të Komunës Qendër, Fier, e cila është pajisur me certifikatë pronësie dhe më është dhënë afat 30 ditor për ta kundërshtuar urdhërin në gjykatë.

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

<sup>3</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin ASHK.

<sup>4</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin ASHK Fier.

<sup>5</sup> Familje e shpronësuar nga regjimi komunist.

<sup>6</sup> Për shkak se ka paditur ASHK-në dhe DVASHK Fier në gjykatë.

ZVRPP Fier ka bërë regjistrimin e pasurisë nr.128/1 ZK 1453 e llojit “terren sportiv” në emër të Komunës Qendër Fier. Brenda afatit ligjor kam ngritur padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, e cila me vendimin nr. 447, datë 31.3.2016 ka rëzuar kërkesë padinë.

Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë kam bërë ankim brenda afatit ligjor. Edhe pse kishte detyrimin ligjor të dorëzonte vendimin e arsyetuar në gjykatë brenda afateve, gjyqtari i çështjes e dorëzoi vendimin përtej afatit ligjor. Për shkeljet e gjyqtarit të çështjes kam bërë ankesë tek Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, inspektorët e të cilit kanë bërë verifikimin e rastit por çështja u arkivua nga ish Kryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Ankimi im kundër vendimit nr. 447, datë 31.3.2016 u regjistrua në Gjykatën Administrative të Apelit, datë 09.09.2016.

Gjykata Administrative e Apelit i tejkaloj afatet e gjykimit dhe për këtë arsye ju drejtova Gjykatës së Lartë me kërkesë për “Konstatimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor për afatet e gjykimit, përshpejtimin e procedurave të gjykimit dhe shpërblimin e dëmit”. Me vendimin nr. 25/22, datë 17.6.2021 Gjykata e Lartë vendosi rrëzimin e kërkesës. Kundër vendimit të Gjykatës së Lartë kam bërë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese e cila me vendimin nr. 3, datë 17.2.2022 vendosi:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Konstatimin e cënimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.
3. Shfuqizimin e vendimit nr. 25/22, datë 17.06.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
4. Detyrimin e Gjykatës Administrative të Apelit për të gjykuar çështjen brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 591, datë 07.12.2022, vendosi:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 447, dt. 31.03.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.
2. Pranimin e kërkesë padisë.
3. Shfuqizimin e urdhërit nr. 664, datë 1.12.2015 të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.
4. Detyrimin e të paditurit Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, të fshijë regjistrimin e pasurisë Nr.128/1 ZK 1453, terren sportiv, sipas VKM nr. 509, datë 06.07.2011 në emër të ish Komunës Qendër Fier, për sipërfaqen 5000 m2.
5. Detyrimin e të paditurit Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, të regjistrojë në përputhje me vendimin nr. 132, datë 14.2.1996 të ish Komisionit të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave të Këshillit të Rrethit Fier, pasurinë Nr.128/1 ZK 1453, Qendër Fier.
6. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.
7. Ky vendim përbën titull ekzekutiv, menjëherë të ekzekutueshëm nga Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor.
8. E drejta e rekursit kundër këtij vendimi mund të ushtrohet në Gjykatën e Lartë brenda 30 ditëve duke filluar nga e nesërmja e komunikimit të palëve ndërgjyqëse.

Përsa më lart, sipas ankuesit: *“Edhe pse vendimi është titull ekzekutiv ASHK Drejtoria Vendore Fier refuzon ta ekzekutojë. Në këtë rast kemi të bëjmë me një diskriminim të hapur që bëhet kundër pronarëve të cilët jo vetëm i është hequr e drejta e pronësisë gjatë regjimit komunist, por edhe sot e kësaj dite u mohohet e drejta pronës. Institucionet shtetërore punojnë me dy standarde, është regjistruar menjëherë dhe pa u kontrolluar aspak nga ana ligjore VKM nr. 509, datë 6.7.2011 dhe nuk regjistrohet prona sipas aktit të pronësisë duke marrë parasysh faktin se vendimet e komisioneve të kthimit kompensimit të pronave ish pronarëve janë tituj ekzekutiv dhe “quasi gjyqësore” dhe vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është i formës së prerë dhe titull ekzekutive. Diskriminimi është i hapur ku nga njëra anë favorizohen institucionet publike kundër zbatimit të ligjit dhe të të drejtave të qytetarëve të thjeshtë.*

*Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është marrë dhe në zbatim të Vendimit nr. 3 , datë 17.2.2022 të Gjykatës Kushtetuese. Diskriminimi është i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë pasi haptazi favorizohet Bashkia Fier në dëm të së drejtës së pronarit legjitim”.*

Më datë 03.04.2023, përmes e-mail-it, Komisioneri iu drejtua subjektit ankues, duke kërkuar plotësimin e saj nga ana formale duke vënë në dispozicion sqarime, prova dhe fakte sa i përket shkaqeve të diskriminimit të pretenduara në ankesë.

Në përgjigje të kërkesave të KMD-së, ankuesi nëpërmjet e-mail-eve datë 04.04.2023 dhe 07.04.2023, informoi Komisionerin ndër të tjera se: “...

*A. ... Institucioni publik po bën një trajtim të diferencuar dhe ndryshe, pasi ka regjistruar pronën në emër të Komunës Qendër Fier, sot Bashkia Fier por refuzon të zbatojë vendimin e gjykatës për të çregjistruar pronën në emër të Komunës Qendër Fier, sot Bashkia Fier dhe të regjistrojë pronën sipas vendimit nr. 132, datë 14.2.1996 të KKKPP Fier, ndërkohë që ligji e detyron të zbatojë vendimin e formës së prerë të gjykatës. Ndërkohë Bashkia Fier përdor pronën private sipas interesave të veta pa asnjë tagër ligjor dhe pengon pronarët të disponojnë dhe ta përdorin pronën në kundërshtim të hapur me ligjin dhe në keqbesim pasi është në dijeni të plotë të vendimit të KKKPP Fier dhe vendimit të gjykatës. Përdorimi i pronës nga Bashkia Fier është prej një kohe relativisht të gjatë prej të paktën 12 vjetësh. Në këto 12 vjet edhe pse ligji është shumë i qartë, asnjë institucion nuk ka marrë mundimin për ta zbatuar. Kërkoj që të merret parasysh fakti se qytetari përballë institucioneve publike është i pafuqishëm dhe jo i barabartë. Institucionet publike e shfrytëzojnë pozicionin e tyre dominues dhe keqpërdorin fuqinë ligjore në dëm të të drejtave të qytetarit. Aplikimi për regjistrimin e pronës është bërë në prill 2015, janë bërë dhe pagesat e nevojshme për reregjistrimin e pronës, pasi sipas ASHK Drejtoria Vendore Fier para vitit 1997 regjistrimet janë djegur. Kanë kaluar 8 vjet nga aplikimi për reregjistrimin.*

*B. ...Institucioni publik ASHK dhe ASHK Fier nuk kanë marrë mundimin as të kthejnë përgjigje dhe nuk kanë asnjë arsye se përse nuk po zbatojnë dy vendime që janë tituj ekzekutiv, përkundrazi ligji është shumë i qartë dhe detyron institucionet të zbatojnë vendimet e formës së prerë të gjykatave. ASHK Fier nuk vepron ndërkohë që Bashkia Fier përdor pronën. Të dyja institucionet po veprojnë në mënyrë të jashtëligjshme në bashkëpunim me njëra tjetrën.*

*Në vlerësimin tim në mbështetje të pretendimeve të mia se shkak për diskriminimin e pretenduar është gjendja sociale, si familje e shpronësuar gjatë regjimit komunist, kjo pronë që i përket regjimit të pronave të shpronësuar, pasi prona në fjalë është një pronë që është shtetëzuar ose thënë ndryshe pronarët u shpronësuan gjatë regjimit komunist në Shqipëri. Statusit të caktuar që kanë personat e shpronësuar që dihet gjerësisht njihen si ish pronarë ose më saktë “Pronarë legjitim” në zbatim të vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, pronarët pavarësisht ligjit të shpronësimeve, i cili është shpallur i padrejtë dhe në shkelje të lirive themelore të njeriut, ata nuk e kanë humbur asnjëherë të drejtën e pronës. E drejta e pronës ka vazhduar pandërprerje edhe gjatë regjimit komunist. Pronarët e shpronësuar gjatë regjimit komunist formojnë një kategori të caktuar sociale dhe shoqërore të drejtat e kësaj kategorie janë cënuar gjatë regjimit komunist...*

*Kam shënuar si arsye “çdo shkak tjetër” në vlerësimin tim karakteristika ose veçantia që mbaj është “Paditës” duke u nisur nga fakti se kam paditur në gjykatë ASHK dhe ASHK Fier dhe se gjykata ka vendosur kundër këtyre institucioneve dhe duke u ndodhur përpara faktit se kanë humbur një proces gjyqësor refuzojnë ta ekzekutojnë atë pa patur një arsye ligjitime dhe të arsyeshme.*

*Mos ekzekutimi i vendimit të gjykatës është në shkelje të nenit 6 të konventës, për një proces të rregullt gjyqësor që lidhet me nenin 14 të po së njëjtës konventë. Diskriminimi duke mos zbatuar një vendim të formës së prerë është në shkelje të konventës për të drejtën e aksesit në drejtësi.*

*Shkeljet e kryera nga instituconet publike janë të rënda dhe diskriminuese pasi ato pengojnë të drejtat ligjitime të njohura nga legjislacioni shqiptar dhe ndërkombëtar, anëtar i së cilës është edhe shteti shqiptar...”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Fier.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:**

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që

krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

*Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:*

- Nga aktet shkresore të depozituara nga ankuesi, rezulton se, pretendimet për zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, ai i ka ndjekur sipas procedurës së përcaktuar në ligj, përmes Përmbauesit Gjyqësor.

Ligji nr. 8730, datë 18.01.2001 *“Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbaimit Gjyqësor”*, i ndryshuar, në nenin 2, të tij, ka përcaktuar se: *“1. Shërbimi i Përmbaimit Gjyqësor ka për mision ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile. 2. Shërbimi i Përmbaimit Gjyqësor i ushtron funksionet nëpërmjet përmbauesve gjyqësorë”*.

Pika 1, e nenit 5, të këtij Ligji përcakton se: *“Përmbauesi gjyqësor është personi i ngarkuar me ligj për kryerjen e veprimtarisë së vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile”*.

Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 *“Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, në nenin 510 të tij ka përcaktuar se, ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv, dhe se janë tituj ekzekutivë, sipas përcaktimeve të këtij neni:

*“a) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përmban një detyrim, vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm;*

Në nenin 515, të tij, K.Pr.C, ka përcaktuar se:

*“Urdhri i ekzekutimit vihet në ekzekutim nga shërbimi përmbaimit gjyqësor, shtetëror ose privat, me anë të përmbauesit gjyqësor, në bazë të kërkesës së kreditorit...”*

Bazuar në sa më lart, Komisioneri vëren se, Shërbimi i Përmbaimit Gjyqësor, ushtron veprimtarinë e tij, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 *“Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbaimit Gjyqësor”*, të ndryshuar, dhe ka për mision

ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile dhe se, personi i ngarkuar me ligj për kryerjen e veprimtarisë së vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile është pikërisht përmbaruesi gjyqësor.

Me shkresën nr. 3 regj., nr. 11, datë 30.01.2023, Shoqëria Përmbarimore Private ....., ka iniciuar procedurën për ekzekutimin vullnetar të Titullit Ekzekutiv Vendimi nr. 591, datë 07.12.2022 i Gjykatës Administrative të Apelit, nga ana e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Fier.

Gjatë ndjekjes së procedurës së ekzekutimit vullnetar të vendimit sipërcituar, në kushtet kur ai nuk ka ndodhur, pas kalimit të afatit për ekzekutim vullnetar, Përmbaruesi Gjyqësor ka filluar procedurën për ekzekutim të detyrueshëm të vendimit.

Evidentohet se veprimet procedurale të Përmbaruesit Gjyqësor për ekzekutimin e këtij vendimi për llogari të ankuesit kanë vijuar dhe aktualisht, ky vendim mbetet i pa ekzekutuar.

Bazuar në sa më lart, Komisioneri vlerëson se është shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor që ka për mision ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë.

Për rrjedhojë, trajtimi i kësaj kërkesë të ankuesit, nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/b, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “Ankesa nuk pranohet nëse .....është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Komisioneri vëren se, nisur nga kërkimet e subjekti ankues, të cilat i referohen ekzekutimit të Vendimit përkatës të Gjykatës Administrative të Apelit; ankuesi, si subjekt i interesuar, mund t'i drejtohet drejtpërdrejtë Gjykatës Kushtetuese.

Kushtetuta e Shqipërisë, në nenin 131, shkronja f) e tij, ka parashikuar se:

“Gjykata Kushtetuese vendos për:

.....f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë.

Pika 1, shkronja i) e pika 2, e nenit 134, të Kushtetutës, përcaktojnë shprehimisht se:

“1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të:

.....i) individëve.

2. Subjektet e parashikuara nga nënparagrafët “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g”, “gj”, “h” dhe “i”, të paragrafit 1, të këtij neni, mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre”.

Neni 44 i Kushtetutës përcakton se: “Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore”.

Neni 142, pika 3 e Kushtetutës përcakton se: “Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”.

Bazuar në sa më lart, si dhe në jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese, lidhur me pretendimet për cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, individët e prekur drejtpërdrejtë, mund t’i drejtohen Gjykatës Kushtetuese.

Subjekti ankues, i ndodhur në kushtet e mësipërme, mund t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese lidhur me pretendimin e tij për cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, nga viti 2022 e deri aktualisht (*Referuar Vendimit nr. 591, datë 07.12.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit*).

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1, germa a), nenit 33, pika 4/b, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Mospranimin e ankesës të paraqitur nga L. K., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Gjendja shoqërore dhe çdo shkak tjetër)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)